



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 129
Prishtinë, më 23 shtator 2010

PROCES\VERBAL

**IMBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 23 SHTATOR 2010**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes dhe i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet e sigurisë private,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Ekonomiko-Social,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 204/33 për blegtorinë e Kosovës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale,

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis,
11. Shqyrtimi i Propozim-strategjisë së Sigurisë të Republikës së Kosovës,
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave,
13. Shqyrtimi i Rekomandimit lidhur me nominimet për Bordin për Ankesa të Mediave nga Gjykata Supreme e Kosovës.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Për deklarime jashtë rendit të ditës diskutuan këta deputetë: Donika Kadaj – Bujupi, Numan Baliq, Lulzim Zeneli, Ibrahim Gashi, Rexhep Hoti, Berim Ramosaj, Zylfi Merxha dhe Naim Rrustemi.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Naim Rrustemi** parashtoi pyetje për ministrin, Bujar Bukoshi, lidhur me arsyet për inicimin e shkarkimit të drejtorit ekzekutiv të QKUK-së, dhe kthimin e tij në të njëjtën pozitë, pas procedurave të ankimit.

Ministri **Bujar Bukoshi**, iu përgjigj pyetjes së deputetit Naim Rrustemi.

Deputeti **Riza Smaka**, parashtoi pyetje për ministrin, Mahir Yagcilar, lidhur me disa parregullsi në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, që kanë të bëjnë me kontratat e punës, përshkrimet e detyrave në punë, procedurat disiplinore, ndërprerjet e punës dhe për mosrespektimin e vendimeve të KPMK-së.

Ministri **Mahir Yagcilar**, iu përgjigj pyetjes së deputetit Riza Smaka.

Deputetja **Nurishahe Hulaj** parashtoi pyetje për zv.kryeministrin, Hajredin Kuçi, lidhur me themelimin e Agjencisë së Mërgatës, nga ana e Qeverisë, të paraparë në Ligjin për Mërgatën e Kosovës.

Zv.kryeministri **Hajredin Kuçi**, iu përgjigj pyetjes së deputetes Nurishahe Hulaj.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme plenare

Procesverbali i mbledhjes plenare, të mbajtur më 15 shtator 2010, u miratua pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet e sigurisë private

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për shërbimet e sigurisë private.

Ministri **Bajram Rexhepi** tha se Projektligji për shërbimet e sigurisë private ka filluar së hartuari nga prilli i vitit 2007, dhe në këtë proces kanë marrë pjesë përfaqësuesit nga ZCN-ja, IND-ja, si dhe nga Shoqata e Kompanive të Sigurisë Private.

Në vazhdim tha se nevoja për këtë projektligj është mjaft e madhe, sepse bëhet rregullimi i kushteve dhe mënyrave për subjektet afariste dhe personat që merren me ushtrimin e veprimtarisë nga fusha private e sigurimit.

Më tej ai vuri në pah se dispozitat e këtij projektligji nuk zbatohen për aktivitetet që rregullohen me Ligjin për policinë, dhe aktivitetet tjera nga fusha e sigurisë të cilat janë përcaktuar për institucionet shtetërore ose qeveritare.

Ky projektligj përbëhet prej 10 kapitujve me gjithsej 53 nene, ka implikime financiare por krijon edhe të ardhura për buxhetin e Kosovës, tha ministri.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për shërbimet e sigurisë private.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Rustem Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Adem Salihaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Shkumbin Demaliaj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Drita Maliqi, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Bujar Dugolli, Bahri Hyseni, Gjylnaze Sylja, Ibrahim Makolli, Naim Rustemi, Naser Rugova, Gani Buçinca, Adem Hajdaraj, Suzan Novoberdaliu, Ibrahim Gashi, Gani Geci dhe Emrush Xhemajli, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62,

Kundër-----2,

Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për shërbimet e sigurisë private.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete e Kthim Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin prej dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit, Projektligjin për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri.

Ministri **Bajram Rexhepi** tha se hartimi i Projektligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse për institucionet e autorizuarra shtetërore për siguri, ka filluar në prill 2009, dhe në këtë proces kanë marrë pjesë përfaqësuesit nga ZCN-ja, IND-ja, etj, qëndrimet e të cilëve janë përfshirë në këtë projektligj.

Në vazhdim tha se ky projektligj përgatitet me prioritet të lartë, nga se kjo fushë deri më tani nuk ka qenë e rregulluar me ligj.

Më tej ai vuri në pah se projektligji rregullon: prodhimin, riparimin, tregtinë, importin, eksportin, vënien e shenjave identifikuese, sigurinë gjatë deponimit dhe transportit, dhe vlerësimin e përputhshmërisë dhe kushtet për armë, municion dhe pajisje përkatëse për siguri, përveç aktiviteteve për FSK-në.

Ky projektligj përbëhet prej 9 kapitujve me gjithsej 38 nene, dhe ka implikime buxhetore shitesë për vitin 2011 dhe 2012, tha ai.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse për institucionet e autorizuarra shtetërore për siguri.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, Rustem Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Basri Musmurati, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Shkumbin Demaliaj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Suzan Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Gani Geci, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputeti Mark Krasniqi dhe ministri Bajram Rexhepi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----68,
Kundër-----0,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse për institucionet e autorizuarra shtetërore për siguri.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Kthim, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin prej dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Ekonomiko-Social

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit, Projektligjin për Këshillin Ekonomiko-Social.

Ministri **Nenad Rashiç**, tha se Qeveria e Republikës së Kosovës është e përgatitur për zbatimin e dialogut social si pjesë e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë, punëdhënësve dhe Sindikatës.

Në vazhdim ai tha se dimensionin social është një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e gjithmbarshëm të shoqërisë.

Më tutje tha se ky projektligj rregullon organizimin, format e punës dhe funksionimin e përgjithshëm të Këshillit Ekonomiko-Social, dhe cakton kriteret për përfaqësimin e partnerëve në këtë organ trepalësh.

Institucionet e Republikës së Kosovës në Këshillin Ekonomiko-Social, përfaqësohen nga ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, ministri i Ekonomisë dhe Financave, ministri i Tregtisë dhe Industrisë, ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe ministri i Shëndetësisë, tha ai.

Në fund ai ftoi deputetët për miratim në parim të Projektligjit për Këshillin Ekonomiko-Social.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për Këshillin Ekonomiko-Social.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Flora Brovina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Nurishahe Hulaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Syla, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Rita Hajzeraj, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Naser Rugova, Mimoza Ahmetaj, Zylfije Hundozi, Riza Smaka, Driton Tali, Ibrahim Selmanaj, Naim Rrustemi, Kaqusha Jashari, dhe ministri Nenad Rashiç, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----64,

Kundër-----0,

Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për Këshillin Ekonomiko-Social.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Kthim, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin prej dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit, Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave.

Ministri **Lutfi Zharku**, tha se Qeveria e Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh nevojën për mbrojtjen e popullsisë në rast të çrregullimit të tregut, mbrojtjes së vendit në situata të jashtëzakonshme, gjendjes së emergjencave civile, veprimeve ushtarake në gjendje lufte etj, ka hartuar Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave, të cilin po e shqyrtomë sot.

Në vazhdim ai tha se projektligji përcakton procedurën e krijimit, sigurimit, financimit, deponimit, ruajtjes, përdorimit, menaxhimit dhe shpërndarjes së rezervave shtetërore të mallrave në vendin tonë.

Për zbatimin e këtij projektligji parashihet edhe krijimi i Departamentit për Rezervat Shtetërore të Mallrave, ndërsa rezervat e mallrave parashihet të mbulohen nga buxheti i Kosovës, tha ai.

Parashihet gjithashtu që Qeveria nëpërmjet ministrit të linjës, t'i drejtohet një herë në vit Kuvendit të Kosovës për gjendjen e rezervave shtetërore të mallrave, konstatoi ministri.

Në fund ai ftoi deputetët për miratim në parim të Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, dhe në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së Myzejene Selmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha – Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vladimir Todoroviç, si dhe deputetët: Bahri Hyseni, Nerxhivane Dauti, Riza Smaka, Naim Rustemi dhe Driton Tali, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----64,
Kundër-----0,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete e Kthim, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, që ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe në afatin prej dy muajve nga shqyrtimi i parë Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 204/33 për blegtorinë e Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 204/33 për blegtorinë e Kosovës.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës arsyetimin e këtij Projektligji e paraqiti ministri **Lutfi Zharku**, i cili tha se ligji në fuqi ka disa mangësi të cilat janë hasur gjatë procesit të zbatimit të tij, sidomos te dispozitat ndëshkimore, e që si rezultat i kësaj ka lindur nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji.

Në vazhdim, ai tha se ky projektligj ka për qëllim rregullimin e çështjeve të cilat lidhen me plotësimin e vakumit ligjor të kontrollit dhe të mbikëqyrjes së mbarështimit të kafshëve dhe prodhimeve blegtorale sipas standardeve zooteknike.

Gjatë hartimit të këtij projektligji janë marrë parasysh përvojat e shtetit slloven dhe ato të shtetit kroat, tha ai.

Në fund, ai ftoi deputetët të miratojnë, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 204/33 për blegtorinë e Kosovës.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtim, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 204/33 për blegtorinë e Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Elheme Hetemi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Zef Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj - Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Hestet Cakolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vladimir Todoroviq, si dhe deputetja Gjylnaze Sylja, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----64,

Kundër-----0,

Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 204/33 për blegtorinë e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin prej dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale

Kryesuesi njoftoi se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale ka qenë i radhitur për shqyrtim të parë në mbledhjen plenare të mbajtur më 11 qershor 2009, mirëpo Qeveria e Republikës së Kosovës ka kërkuar shtyrjen e shqyrtimit të parë këtij projektligji për një muaj.

Ndërkohë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e projektligjit nga procedura e shqyrtimit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Nurishahe Hulaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaz Sylaj, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim kërkesën e Qeverisë për tërheqjen e projektligjit nga procedura e shqyrtimit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----52,

Kundër-----1,

Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës për tërheqjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë nga procedurat parlamentare.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis

Kryesuesi njoftoi Kuvendin se Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryesuesi i hodhi në votim një nga një amendamentet e komisionit funksional.

Kuvendi miratoi amendamentin nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20, të propozuar në Projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Kryesuesi në vazhdim hodhi në votim tekstin e Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----59,

Kundër-----0,

Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

11. Shqyrtimi i Propozim-Strategjisë së Sigurisë të Republikës së Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Propozim-Strategjinë e Sigurisë të Republikës së Kosovës.

Ministri **Bajram Rexhepi** tha se për një shtet demokratik parësore janë çështjet që lidhen me sigurinë e një vendi.

Në vazhdim, ai tha se të drejtat e qytetarëve dhe siguria publike janë çështje që, përveç atyre të karakterit të sigurisë, ngërthejnë në vete edhe zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Propozim-Strategjinë e Sigurisë të Republikës së Kosovës, e cila është në pajtim me nenin 127 të Kushtetutës së Kosovës dhe në pajtim me ligjin, e ka përgatitur Këshilli i Sigurisë së Kosovës.

Më tutje, ministri elaboroi përmbajtjen e kësaj propozim-strategjie, e cila përbëhet prej tre kapitujve, ndërsa ndryshimi dhe plotësimi i saj mund të bëhet varësisht prej situatës së përgjithshme të sigurisë në vend.

Në fund, ai ftoi deputetët të miratojnë Propozim-Strategjinë e Sigurisë të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin e Propozim-Strategjisë së Sigurisë të Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë propozim-strategji dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Rustem Mustafa, në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e AKI-së, Mimoza Ahmetaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Berim Ramosaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar “7+” Zylfi Merxha, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Emrush Xhemajli, Driton Tali, Naim Rustemi, Gjylnaze Sylja, Mimoza Ahmetaj, Ibrahim Gashi dhe zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Propozim-Strategjisë së Sigurisë të Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----45,
Kundër-----19,
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Strategjinë e Sigurisë të Republikës së Kosovës, me rekomandimet e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri.

12 Shqyrtimi i Propozim–vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave

Kryesuesi njoftoi Kuvendin se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Propozim–vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin e emërimit të anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Drita Maliqi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Propozim–vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----42,
Kundër-----23,
Abstenime-----6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave

I. Anëtarë të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave emërohen:

1. Arben Canolli,
2. Samir Lleshi,
3. Arben Avdiu,
4. Agim Bivolaku,
5. Nexhat Hasani,
6. Përparim Hoxha,
7. Lulzim Zeka,
8. Afrore Rudi,
9. Faik Çollaku,
10. Ismail Kovaç.

II. Mandati i të emëruarve nga pika I e këtij vendimi zgjatë dy (2) vjet.

13. Shqyrtimi i Rekomandimit lidhur me nominimet për Bordin për Ankesa të Mediave nga Gjykata Supreme e Kosovës

Kryesuesi njoftoi Kuvendin se Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media ka shqyrtuar Propozimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin e emërimit të anëtarëve në Bordin për Ankesa të Mediave nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë: në emër të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, Esat Brajshori, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, dhe deputeti Nait Hasani, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----41,
Kundër-----21,
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M **Për emërimin e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave**

I. Anëtarë të Bordit për Ankesa të Mediave emërohen:

1. Avdi Dinaj,
2. Visar Morina.

II. Mandati i të emëruarve nga pika I e këtij vendimi zgjatë tre (3) vjet.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 18:00 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale